



Prishtinë: 28.01.2019

Kodi i ZRRE-së: V_115_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1892_12_18**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **08.01.2018**.

në seancën e mbajtur më datë 28.01.2019, nxori këtë:

V E N D I M

- I REFUZOHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin B.A. nga Prishtina, me shifër të konsumatorit: DPR -124898, si e pa bazuar.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_1892_12_18** i datës 07.12.2018.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 06.11.2018 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë për këto shkaqe: Përfaqësuesi i KESCO-së, në ankesë ka theksuar se ZRRE/DMK vendmin e saj e ka bazuar vetëm në mesataren e shpenzimit të energjisë elektrike në periudha të ndryshme dhe kjo nuk mund të merret si argument për korrigjimin e faturës, pasi që konsumatori nuk mund të bëjë gjithmonë shpenzim të njëjtë. KESCO në ankesë ka thesaur se konsumatori ka bërë keqpërdorim të njehsorit elektirk dhe se zakonisht pas ndërrimit të njehsorit është tendenca e zvogëlimit të shpenzimit të energjisë elektrike. KESCO në ankesë ka theksuar se në rastet e ngjajshme kur njehsori ka pasur çrregullime ka analizaur me kujdes lëndën dhe ka bërë korrigjimet e nevojshme, ndërsa në rastin e konsumatorit kemi manipulim të njehsorit elektrik dhe se çdo aprovim do të ishte aprovim i kerpërdorimit. KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së që pezullojnë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_1892_12_18 i datës 07.12.2018 për konsumatorin B.A. me shifër DPR – 124898 dhe të mbetet në fuqi fatura 08/2017.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 28.01.2019 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se ZRRE/DMK vendmin e saj e ka bazuar vetëm në mesataren e shpenzimit të energjisë elektrike në periudha të ndryshme dhe kjo nuk mund të merret si



argument për korrjimin e faturës, Bordi i ZRRE thekson se analiza e rrjedhës së energjisë elektrike është një element mjaft i rëndësishëm gjatë shqyrtimit të lëndëve të konsumatorit. Bordi i ZRRE gjithashtu thekson se punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse me datë 24.07.2017 kur kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve në njehsorin elektrik nr.7863593 prej TL=16509 kWh dhe TU=80926 kWh, poashtu kanë theksuar se ndërrimi i njehsorit bëhet pasi dyshohet në saktësinë e matjes. Po atë ditë ekipi i njëjtë i KEDS-i ka larguar nga matja njehsorin elektrik nr.7863593 me gjendje TL=16509 kWh dhe TU=80926 kWh, si dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 67787224 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh. Pra, siç shihet vendimii organit të shkallës së parë nuk është bazuar vetëm në krahasimin e shpenzimit të energjisë elektrike por edhe në shkresat tjera të lëndës.

Se krahasimi i shpenzimit të energjisë elektrike është i rëndësishëm e dëshmon fakti se ZRRE ka analizuar me kujdes shpenzimin e faturuar në periudhën 08/2017 prej 8265 kWh dhe shpenzimin e energjisë elektrike para dhe pas kësaj periudhe, dhe ka rezultuar se konsumatori ka ndryshim të vogël në shpenzim të energjisë për periudha të njëjta kohore. Për më tepër Bordi i ZRRE thekson se mesatarja e shpenzimeve me njehsorin e vjetër nr.7863593 për periudhën 09/2016 deri në periudhën 05/2017 është 1,224 kWh/muaj, kurse me njehsorin e ri elektrik nr. 67787224 mesatarja mujore e shpenzimit për periudhën 09/2017 deri në periudhën 05/2018 është 1,370 kWh/muaj. Bazuar në këtë konstatohet se konsumatori me njehsorin e ri elektrik për periudhë të njëjtë ka një rritje prej 12% të shpenzimit krahasuar me njehsorin e vjetër.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të paditësit KESCO se konsumatori ka bërë keqpërdorim të njehsorit elektrik dhe se zakonisht pas ndërrimit të njehsorit ekziston tendenca e zvogëlimit të shpenzimit të energjisë elektrike, Bordi i ZRRE-së thekson se po të ishte keqpërdorim atëherë kjo lëndë do të duhej të trajtohej si shfrytëzim i paautorizuar i energjisë elektrike nga ana e KESCO dhe KEDS, dhe ZRRE nuk do të kishte mandat ta shqyrtonte sipas nenit 61 të Ligjit për Energjinë Elektrike dhe nenit 4, paragrafi 2 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, por KESCO e ka faturuar konsumatorin me faturim të rregullt të energjisë elektrike. Ndërsa sa i përket pohimit të KESCO-s se pas ndërrimit të njehsorit elektrik ekziston tendenca e zvogëlimit të shpenzimit të energjisë elektrike nga ana e konsumatorit, Bordi i ZRRE-së thekson se edhe kjo nuk qëndron pasi nuk mundet konsumatori për muaj të tërë e vite të tërë të zvogëlojë shpenzimin për qëllim të tillë.

Lidhur me këtë Bordi i ZRRE-së thekson se bazuar në të gjitha shkresat e lëndës ka vërejtur se shpenzimi i energjisë elektrike (kWh) i faturuar në faturën nr.0817228213DPR-124898 nuk paraqet shpenzim real mujor të konsumatorit, andaj duke u bazur në këtë dhe në mos përputhjen e shpenzimi i energjisë elektrike (kWh) të faturuar në periudhën gusht 2017 me shpenzimet reale mujore, konstaton se faturimi i periudhës gusht nuk paraqet shpenzim real të konsumatorit andaj edhe duhet të anulohet fatura nr.0817228213DPR-124898 të datës 24.08.2017 dhe se për këtë periudhë konsumatori duhet të faturohet me shpenzimet e periudhës korrik 2018 prej TL=870 kWh dhe TU=223 kWh.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 28.01.2019 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit B.A. dhe
- Arkivit të ZRRE-së.